



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 114, Datë 27.07.2017

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “d”; 5, pika 1, gërma “d”; 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

ERE me Vendimin nr. 68, datë 11.05.2017, vendosi mos fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se u konstatua mungesë e dokumentacionit teknik, si dhe mungesa e pagesës së aplikimit për paisje me licencën e furnizimit të energjisë elektrike.

ERE më shkresën nr. 352/2 Prot., datë 22.05.2017, njoftoi subjektin “Albanian Green Energy” sh.p.k., për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 059 Prot., datë 06.06.2017, paraqiti në ERE brenda afateve të përcaktuara në nenin 10, pika 7, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikim, Transferim, Rinovim ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjise Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, dokumentacionin e munguar për të plotësuar aplikimin e tij, si dhe kreu pagesën e aplikimit për paisjen me licencë furnizimi me energji elektrike.

Me vendimin nr. 102, datë 04.07.2017, Bordi i ERE filloi procedurën për licensimin e Shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5- vjeçar.

Aplikimi i shoqërisë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “a1”, “b1”, “c1”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ANËTARI I BORDIT TË ERE
Adriatik BEGO